



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr.1012/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Auto Mita” Sh.p.k., me numër unik identifikues ..... dhe seli në Prishtinë, magjistrerja Prishtinë – Shkup, fshati Preocë, kundër debitorit Komuna e Prishtinës, me seli në Prishtinë, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 457/21, i lejuar me datë 25.10.2021, nga Përmbartuesi Privat Rezarta Metaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 29.05.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit Komuna e Prishtinës, ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 457/21, i lejuar me datë 25.10.2021, nga Përmbartuesi Privat Rezarta Metaj.
- II. Urdhri Përmbartimor P.nr. 457/21, i lejuar me datë 25.10.2021, nga Përmbartuesi Privat Rezarta Metaj, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, mbi bazën e dokumenteve të besueshme; faturës nr. 20-SHV04-AQP-263, e datës 05.03.2020, faturës nr. 20-SHV04-AQP-264, e datës 05.03.2020, faturës nr. 20-SHV04-AQP-265, e datës 05.03.2020, ka lejuar urdhrin përmbartimor P.nr. 457/21, të datës 25.10.2021, ndaj debitorit për arkëtimin me dhunë të obligimit në emër të borxhit në shumë prej EUR 934.80, me kamatë ligjore prej 8% në vit duke filluar nga data e arritshmërisë për pagesë, e deri në përmbushje definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim duke e kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbarimor me arsyetim se faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri nuk i përmbushin tiparet e përmbarueshmërisë dhe nuk kanë titull ekzekutiv, siç parashihet me nenin 22 lidhur me nenin 29 të LPP-së. Ka shtuar se të njëjtave i mungon koha e përmbushjes së detyrimit dhe nuk janë të nënshkruara, vulosura apo pranuar nga ana e debitorit, rrjedhimisht janë të njëanshme ngase kreditori me debitorin nuk kanë pasur asnjë raport juridik mes vete. Për këtë arsye, gjykatës i ka propozuar që ta aprovoj prapësimin e debitorit në tërësi si të bazuar, ashtu që urdhri përmbarimor të anulohet dhe të obligohet kreditori që t'ia kompensoj debitorit shpenzimet në emër të përpilimit të prapësimi.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka theksuar se pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim janë të pabazuara, për arsye se faturat e paraqitura si dokumente të besueshme i plotësojnë të gjitha kushtet ligjore për tu konsideruar si dokumente të përshtatshme për përmbarim. Ka shtuar se faturat në fjalë i plotësojnë të gjitha elementet e dokumentit të besueshëm, e për më tepër të njëjtat janë të pranuar dhe nënshkruara nga debitori. Në fund, ka theksuar se prapësimi i debitorit është në kundërshtim me nenin 69, paragrafi 4 të LPP-së, ngase debitori nuk ka bashkangjitur asnjë provë për ti mbështet pretendimet e tij. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që ta refuzoj si të pabazuar prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, për arsyet si në vijim:

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së: *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa paragrafit 1.3 i të njëjtit nen përcakton faturën si dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, me paragrafin 3, të të njëjtit nen parashihet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Në anë tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së: *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*.

Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përbaruesit privat bazohet në dokumente të besueshme, përkatësisht e përshkuara si në hyrje të këtij aktvendimit, të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm siç kërkohet me nenin 29, paragrafi 3 të LPP-së, për arsye se në to janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë emërtuar shërbimet, përkatësisht mallrat me të cilat është shërbyer debitori, si dhe është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit. Gjithashtu, gjykata gjen se faturat në fjalë janë lëshuar me rregull nga ana e kreditorit dhe të njëjtat debitori i ka pranuar dhe nënshkruar.

Poashtu, nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori, në kuptim të nenit 30 të LPP-së, ka paraqitur deklaratë me shkrim përmes së cilës ka treguar se borxhi nga faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri është bërë i kërkueshëm pas kalimit të afatit prej 30 ditë nga data e pranimit të secilës prej faturave.

Rrjedhimisht, gjykata vlerëson se faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së, për zbatimin e përbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat i janë bashkangjitur propozimit për përbarim në origjinal.

Gjykata, pati parasysh pretendimet e debitorit i cili ka theksuar se faturat janë fiktive ngase nuk janë nënshkruar, vulosur apo pranuar nga debitori, mirëpo të njëjtat i gjeti si të pabazuara, ngase në shkresa të lëndës, rezulton se debitori ka pranuar me rregull faturat dhe ka qenë i njoftuar me detyrimin që buron nga të njëjtat. Ky fakt vërtetohet edhe nga shkresa e datës 10.03.2020, përmes së cilës shefit autopark, z. Shaban Maliqi, nëpërmes Drejtorisë së Administratës së Komunës së Prishtinës, i është drejtuar Drejtorisë së Financave në kuadër të Komunës së Prishtinës, me kërkesë për pagesën e faturave mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri.

Gjykata pati parasysh edhe pretendimet e tjera të debitorit, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk paraqesin bazë për anulimin e urdhrit mbi lejimin e përbarimit, në kuptim të nenit 71 të LPP-së.

Në këtë drejtim, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore të përcaktuara në nenin 71 të LPP-së, mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përbarimit, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga sa më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1012/22, datë 29.05.2023

Gjyqtari  
Arbër Rexha

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.